

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Artan Sejrani si kryetar i trupit gjykues, si dhe gjyqtarët Ajser Skenderi dhe Vjollca Buzhala si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarve A. S.1 na fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe dy veprave penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, I. S. nga fshati C., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, A. S.2 nga fshati C., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, E. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, V. K. nga fshati K., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, A. P. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, L. P. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, Xh. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, Xh. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, L. T. nga fshati B., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, F. H. nga fshati C., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe L. S. nga fshati B., Komuna e Podujevës, për shkak të dy veprave penale keqperdorimi i pozitës, apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag.1 pika 2.1 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.283/2016 të datës 19.05.2017, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e të akuzuarve, dhe mbrojtësit av. N. R. nga Prishtina, në mungesë të prokurorit të shtetit dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar M. B., më datë 14.03.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1. A. S.1 nga i ati S. dhe e ëma H. e vajzërisë B., i lindur më *data e lindjes...* në fsh. B., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fasader, i martuar baba i tre femive, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

2. I. S., nga i ati I. dhe e ëma H. e vajzërisë C., i lindur më *data e lindjes...* në Prizren, me banim në fshatin C., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor, i martuar baba i tre femive, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

3. A. S.2, nga i ati I. dhe e ëma D., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...* në Prizren, me banim në fshatin C., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor, i martuar baba i dy femive, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal *numri personal...*

4. E. S., nga i ati Rr., dhe e ëma M., e vajzërisë T., i lindur më *data e lindjes...* në Suharekë, me banim në fshatin B., Komuna e Suharekës, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor, beqar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

5. V. K., nga i ati B. dhe e ëma M., e vajzërisë D., i lindur më *data e lindjes...* në Suharekë, me banim në fshatin K., Komuna e Suharekës, ka të kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor, beqar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

6. A. P., nga i ati I. dhe e ëma H., e vajzërisë K., i lindur më *data e lindjes...* në Suharekë, me banim në fshatin B., Komuna e Suharekës, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, fasader, i martuar baba i tre femive, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

7. L. P., nga i ati N., dhe e ëma Z. e vajzërisë K. i lindur më *data e lindjes...*, në Prizren, me banim në fshatin B., Komuna e Suharekës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fasader, i martuar baba i dy femive, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

8. XH. S., nga i ati R. dhe e ëma Xh., e vajzërisë A., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin B., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

9. XH. S., nga i ati R., dhe e ëma Xh. e vajzërisë A., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin B., K. e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

10. L. T., nga i ati R. dhe e ëma D., e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin B., K. e Malishevës, ku edhe tani jetonë, ka të kryer fakultetin e psikologjise, i gjendjes së dobët ekonomike, arsimtar, i martuar baba i nje femiju, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *data e lindjes...*

11. F. H., nga i ati M. dhe e ëma S. e vajzërisë T., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin C., K. e Malishevës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, blektor, beqar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

12. L. S., nga i ati A. dhe e ëma F. N. e vajzërisë M., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin B., K. e Podujevës, ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin ekonomike, punon si drejtor i pagesave në AZHB, i martuar baba i dy femive, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numri personal...*

JANË FAJTOR

Të akuzuarit A. S.1

I. I akuzuari A. S.1 i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 23.04.2014 me aplikacionin nr. 136 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur e dokumentin e falsifikuar "Certifikata e vreshtarit" me nr. identifikues 71518081 të datës 16.04.2014, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dymijë e shtatëqind euro (2.700.00) euro, ndërsa certifikata me nr. 71518081 rezulton të jetë e personit B. C. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

1.2. I akuzuari A. S.1 i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 13.05.2015, me aplikacionin nr. 11914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentin e falsifikuar "Certifikata e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015, në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë pesëqind e tridhjetë euro (1.530.00 euro), ndërsa certifikata me nr.72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

1.3 I akuzuari A. S.1, me dt. 16.04.2014, me dije përdor dokumentin publik të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë të zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikata e vreshtarit me nr. Identifikues 71518081 në emër të tij është e falsifikuar, ia bashkëngjit si origjinal aplikacionit nr. 11914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 71518081 rezulton të jetë e personit B. C. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

1.4 I akuzuari A. S.1, me dt. 07.05.2015, me dije përdor dokumentin publik të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i Drejtorisë së

bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikata e vreshtarit me nr. Identifikues 72111038 dt.07.05.2015, është falsifikuar, ia bashkëngjitë si original aplikacionit nr. 11914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me datë cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 71518081 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

I akuzuari I. S.

3.1 I akuzuari I. S. i paraqt organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatat e vreshtarit" me nr. identifikues 72110305 dt. 05.05.2015 në emër të Xh. S. dhe me nr. identifikues 72100002 dt. 29.04.2015 në emër të N. S., gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e treqind e tridhjetë euro (1,330) euro.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

I akuzuari A. S.2

4.1 I akuzuari A. S.2 i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencion e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015, me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direktet për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatat e vreshtarit" me nr. identifikues 72110307 dt. 30.04.2015 në emër të R. S. dhe me nr. identifikues 72110685 dt. 29.04.2015, në emër të H. S. gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e treqind e tridhjetë euro (1,330.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

I akuzuari E. S.

5.1 I akuzuari E. S. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 13.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direktet për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 në emër të vet, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro), ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

5.2 I akuzuari E. S. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 13.04.2014 me aplikacionin nr. 1243 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 71518082 dt. 11.04.2014, në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

5.3. I akuzuari E. S., me dt. 12.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikatat e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 janë të falsifikuar, ia bashkëngjit si origjinal aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KPK-së.

I akuzuari V. K.

6.1 I akuzuari V. K. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikata e vreshtarit" me nr. identifikues 71800128 dt. 12.04.2015 në emër të S. K. dhe me nr. identifikues 71800139 dt. 20.05.2015 në emër të F. K., gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.) euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

6.2 I akuzuari V. K. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 13.04.2014 me aplikacionin nr. 1243 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit", gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë euro (2,680.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

I akuzuari A. P.

7.1 I akuzuari A. P. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt.13.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro), ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

7.2 I akuzuari A. P., me dt 13.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 janë të falsifikuar, ia bashkëngjit si origjinal aplikacionit nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

I akuzuari L. P.

8.1 I akuzuari L. P. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015 me aplikacionin nr. 1994 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej njëmijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro), ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

8.2 I akuzuari L. P. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 23.04.2014 me aplikacionin nr. 136 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për

bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit me nr. identifikues 71518088 dt. 15.04.2014, në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë euro (2,570.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

8.3 I pandehuri L. P., me dt. 12.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikatat e vreshtarit me nr. Identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 janë të falsifikuar, ia bashkëngjit si origjinal aplikacionit nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

I pandehuri Xh. S.

9.1 I akuzuari Xh. S. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro) ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

9.2. I akuzuari Xh. S., me dt. 12.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si origjinal, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikatat e vreshtarit me nr. Identifikues 72111038 dt.07.05.2015 janë falsifikuar, ia bashkëngjit si origjinal aplikacionit nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

I akuzuari Xh. S.

10.1 I pandehuri Xh. S. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencionit e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë

mënyrë që në Suharekë me dt. 12.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 në emrin e tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë e katër qind e tridhjetë euro (1,430.00 euro), ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

10.2 I akuzuari Xh. S. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 25.04.2014 me aplikacionin nr. 137 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit" me nr. identifikues 71518077 dt. 12.04.2014, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej dymijë e dyqind e nëntëdhjetë euro (2,290.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

10.3 I akuzuari Xh. S., me dt. 12.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si original, në atë mënyrë që në Suharekë të zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikatat e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 dt. 07.05.2015 janë të falsifikuar, ia bashkëngjit si original aplikacionit nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

I akuzuari L. T.

11.1 I akuzuari L. T. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt.12.05.2015 me aplikacionin nr.19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkangjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 dt.07.05.2015 në emër të tij, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro) ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

11.2. I akuzuari L. T., me dt.12.05.2015 me dije përdor dokumentet publike të falsifikuar si original, në atë mënyrë që në Suharekë te zyrtari kompetent i Drejtorisë së bujqësisë të komunës së Suharekës, duke ditur se certifikatat e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 dt.07.05.2015 janë të falsifikuar, ia bashkëngjit si original aplikacionit nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, me të cilat edhe fiton subvencione nga Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ndërsa certifikata me nr. 72111038 rezulton të jetë e personit B. (R.) J. nga Rahoveci.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 parag. 2 i KP-së.

I akuzuari F. H.

12.1 I akuzuari F. H. i paraqet organit kompetent të dhëna të pasakta lidhur me aplikimin për marrjen e një subvencioni e që është kusht për marrjen e subvencionit në atë mënyrë që në Suharekë me dt. 13.05.2015 me aplikacionin nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese aplikon në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë të Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural duke ia bashkëngjitur dokumentet e falsifikuar "Certifikatën" e vreshtarit me nr. identifikues 72110829 dt. 27.05.2015, në emër të Shaip Hotit, gjoja se merret me vreshtari dhe fiton nga kjo agjenci subvencionin prej një mijë e dyqind e tridhjetë euro (1,230.00 euro).

Këso dore ka kryer veprën penale mashtrim me subvencione neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së.

I akuzuari L. S.:

Konform nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të KPP-së,

LIROHET NGA AKUZA

13.1 I akuzuari L. S., në muajin qershor të vitit 2014, në cilësi të personit zyrtar - shef i divizionit të pagesave direkte pranë agjencionit për zhvillim të bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë në Prishtinë, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare nuk i përmbushë detyrat zyrtare të parapara me nenin 13 të Rregullorja nr. 01/2012 për detyrat, përgjegjësitë dhe strukturën organizative të Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë në atë mënyrë që pa verifikuar dokumentet e fermerëve dhe gjendjen në teren, lejon përfitim të subvencioneve - pagesat direkte për vreshtat ekzistuese në kundërshtim të dispozitave të Udhëzimi administrativ nr.02/2014 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2014, e Ministrisë së Bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimin rural, e pikërisht nenit 16 që parasheh kriteret e pranueshme për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, neni 19 që përcakton procedurat administrative për zbatimin e pagesave direkte dhe nenit 25 që përcakton shqyrtimin e aplikacionit, për fermerët L. P., A. S., Xh. S., A. B. dhe V. K., e të cilët fermerët nuk kishin vreshta ekzistuese, me ç'rast i shkakton dëm buxhetit të Kosovës në lartësi të subvencioneve të dhëna për këta fermerë në shumë totale prej pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro (15,660 euro).

Këso dore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 pika 2.1 të KP-së.

13.2. I akuzuari L. S., në muajin qershor të vitit 2014, në cilësi të personit zyrtar - shef i divizionit të pagesave direkte pranë agjencionit për zhvillim të bujqësisë në kuadër të Ministrisë së bujqësisë në Prishtinë, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare nuk i përmbushë detyrat zyrtare të parapara me nenin 13të Rregullorja nr, 01/2012 për detyrat, përgjegjësitë dhe strukturën organizative të Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë, në atë mënyrë që pa verifikuar dokumentet e fermerëve dhe gjendjen në teren, lejon përfitim të subvencioneve - pagesat direkte për vreshtat ekzistuese në kundërshtim të dispozitave të Udhëzimi administrativ nr.02/2015 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2015, e Ministrisë së Bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillim rural, e pikërisht neni 19 i saj, e cila parasheh kriteret e pranueshme për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese, neni 23 që përcakton procedurat administrative për zbatimin e pagesave direkte, neni 29 që përcakton shqyrtimin e aplikacionit, që përcakton shqyrtimin e aplikacionit, për fermerët A. S.1, I. S., Xh. S., A. S.2, L. P., A. P., V. K., L. T., A. B., E. S. dhe F. H., e të cilët fermerët nuk kishin vreshta ekzistuese, me ç'rast i shkakton dëm buxhetit të Kosovës në lartësi të subvencioneve të dhëna për këta fermerë në shumë totale, prej pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet euro (15,520 euro).

Këso dore kishte për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 pika 2.1 të KP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73, 74, 80, 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 dhe 398 parag. 1 të KP-së dhe nenit 365 parag.1 të KPP-së, të akuzuarit i:

GJYKON

1. A. S.1, për katër veprat penale dhe atë për pikën 1.1, 1.2 , 1.3 dhe 1.4 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqindtë) euro.**

2. I. S., për veprën penale dhe atë për pikën 3.1 të dispozitivit, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

3. A. S.2, për veprën penale dhe atë për pikën 4.1 të dispozitivit, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

4. E. S., për tri vepra penale dhe atë për pikën 5.1, 5.2, dhe 5.3 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) euro.**

5. V. K., për dy vepra penale dhe atë për pikën 6.1 dhe 6.2 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.**

6. A. P., për dy vepra penale dhe atë për pikën 7.1 dhe 7.2 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.**

7. L. P., për tri vepra penale dhe atë për pikën 8.1, 8.2, dhe 8.3 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) euro.**

8. Xh. S., për dy vepra penale dhe atë për pikën 9.1 dhe 9.2 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.**

9. Xh. S., për tri veprave penale dhe atë për pikën 10.1, 10.2 dhe 10.3 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) euro.**

10. L. T., për dy vepra penale dhe atë për pikën 11.1 dhe 11.2 të dispozitivit, për secilën vepër veç e veç i shqiptohet dënimi me gjobë me nga 300 (treqind) euro.

- **Në kuptim të nenit 80 parag. 1 e 2 nën parag. 2.4, të akuzuarit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.**

11. F. H., për veprën penale dhe atë për pikën 12.1 të dispozitivit, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Të akuzuarit obligohen që në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ti paguajnë dënimet e shqiptuara me gjobë. Në rast se të akuzuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobë apo nuk mundën ti paguajnë, dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do t'iu caktohet një ditë burgim.

Pala e dëmtuar Agjencia për zhvillimin e bujqësisë (AZHB) rr. "Luan Haradinaj" - ish ndërtesa e bankës së Ljublanës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor në lartësi me nga 100 euro, si dhe secili veç e veç me nga

50 euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Për të akuzuarin L. S. shpenzimet e procedurës bien barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtuar aktakuzën PP/I.nr.283/2016 të datës 19.05.2017, kundër të akuzuarve A. S.1 na fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe dy veprave penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, I. S. nga fshati C., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, A. S. nga fshati C., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, E. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, V. K. nga fshati K., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së, A. P. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, L. P. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, Xh. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, Xh. S. nga fshati B., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, L. T. nga fshati B., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 parag. 2 të KP-së, F. H. nga fshati C., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale mashtrim me subvencione nga neni 336 parag. 1 lidhur me parag. 2 të KP-së dhe L. S. nga fshati B., Komuna e Podujevës, për shkak të dy veprave penale keqperdorimi i pozitës, apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag.1 pika 2.1 të KP-së.

Prokurori i shtetit Ervehe Gashi fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtuar me shkrim. Në të cilën fjalë përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se pas analizimit të provave dhe atë nga aplikacioni për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese me numër të aplikacionit 1463 në emër të A. S.1 dhe 19914, në emër të A. S.1, 19914 në emër të I. S., 19914 në emër të A. S.2, 1243 në emër të E. S. dhe 19914 në emër të E. S., 19914 në emër të V. K., aplikacioni nr. 19914 në emër të A. P., nr. 136 në emër të L. P. dhe nr. 19914 në emër të L. P., nr. 19914 në emër të Xh. S., nr. 137 në emër të Xh. S. dhe 19914 në emër të Xh. S., nr. 19914 në emër të L. T., nr. 19914 në emër të F. H., vërtetohet se këta të akuzuar kanë aplikuar për subvencione për vreshta ekzistuese në bazë të cilave në vitin 2014 dhe 2015 kanë fituar subvencionet. Me rastin e analizimit të këtyre aplikacioneve, rezulton se të gjitha aplikacionet mbajnë numrin 19914 e nëse i referohemi deklaratës së dëshmitarit I. K. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ai deklaroi se çdo aplikacion me numër të veçantë dhe

është unik, nuk mundet me të njëjtin numër të jenë dy aplikacione, nga çka rezulton se këto aplikacione janë dorëzuar në organin kompetent pa u verifikuar. Certifikata e vreshtarit 72111038 sipas evidencës së departamentit të vreshtave figuron me emrin B. R. J. nga Rahoveci, këtë gjë e vërteton edhe ortofotot nga vendi i ngjarjes, kështu që certifikatat e vreshtarit me këtë numër në emër të E. S., L. P., Xh. S., Xh. S. dhe A. S.1 nuk janë certifikata origjinale, por të ndryshuara dhe nga provat e çështjes rezulton se këto certifikata me këtë numër i kanë përdorur të akuzuarit E. S., L. P., Xh. S., Xh. S. dhe A. S.2 dhe në bazë të këtyre kanë fituar subvencionet për vreshtat direkte. Me certifikatën e vreshtarit me nr.71518081 të cilën e ka përdorur i akuzuari A. S.1 po ashtu është ndryshuar nga ortofotot dhe departamenti i vreshtarëve të ministrisë së bujqësisë rezulton se kjo certifikata e vreshtarit i takon qytetarit B. C. nga Rahoveci. Me rastin e analizimit të këtyre certifikatave dhe analizimit të deklaratës së dëshmitarit N. M., rezulton se këta të akuzuar nuk kanë qenë vreshtar aktiv, e as që kanë qenë të regjistruar në regjistrin e vreshtave të divizionit të vreshtarisë në departamentin e vreshtave në Rahovec dhe pasi që ka bërë verifikimin e certifikatave të lëshuara, ka rezultuar se ato certifikata nuk janë në emër të atyre personave që i ka dërguar agjensioni i pagesave për verifikim, po ashtu ka deklaruar që nuk e dinë se si këta persona janë pajisur me këto certifikata, nga kjo rezulton se certifikatat që i kanë përdorur të akuzuarit si dokument për të fituar subvencione janë certifikata të rrejshme, pra të ndryshuara dhe të falsifikuara. Këtyre provave kur ti shtohet edhe deklarata e dëshmitares M. B., se gjithë herë aplikacionet ndahen në komuna dhe bujqit aplikojnë nëpër komuna, respektivisht në drejtoritë për bujqësi të Komunës përkatëse. Këto aplikacione i pranojnë zyrtarët komunal dhe obligimi i tyre është të vërtetojnë se a është dokumentacioni në rregull, ndërsa sipas nenit 27 parag. 4 të udhëzimit administrativ me nr. 02/2015 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2015 parashihet që aplikuesi me nënshkrimin e tij siguron të gjitha informatat e dhëna të jenë të qarta të besueshme dhe ai do të lejon kryerjen e kontrollit në teren, atëherë nënkuptohet se vërtetësinë të dokumenteve të bashkangjitura e bartë personi që aplikon pasi që mbledhen të gjitha aplikacionet dorëzohen në agjencin - divizionin për pagesa direkte, i cili bënë kontrollimin administrativ të dokumenteve. Dëshmitarja M. B. vërteton se kur një fermer me aplikacion parashtron dokument të falsifikuar ose jo të vërtetë dhe mbi atë dokument aprovohet një subvencion, përgjegjësia bie mbi zyrtarin komunal që e pranon aplikacionin dhe personat përgjegjës që e trajton lëndën në AZHB të divizionit përkatës, në rastin konkret divizioni për pagesa direkte - subvencione. Nga provat e administruara e pikërisht nga deklarata e Xh. K., rezulton se në drejtorinë për bujqësi të komunës së Suharekës, nuk ekzistojnë të dhënat për këta fermer dhe të dhëna që ata kanë aplikuar përmes Komunës së Suharekës, këtë dëshmi e vërtetojnë dhe e mbështesin edhe dëshmitë e dëshmitarëve p. B., I. K., V. S., I. M., L. K. dhe I. B. duke theksuar se këta të akuzuar si fermer, respektivisht aplikacionet e tyre nuk kanë qenë të regjistruar në sistem. Pohimin e të akuzuarit L. S. se sistemi i regjistrimit të subvencioneve për vreshta ekzistuese ka pasur probleme të theksuara, kundërshtohet nga deklarata e këtyre dëshmitarëve të cilët punojnë në mirëmbajtjen e sistemit të informatikës, që të gjithë kanë pohuar që programi për vreshta ekzistuese nuk ka pasur probleme gjatë futjes së të dhënave, po ashtu që të gjithë kanë deklaruar se ata nuk kanë çasje dhe nuk guxojnë ti fusin të dhënat në sistem, por ndihmojnë stafin duke i udhëzuar se si ti tejkalojnë problemet eventuale, ku pohim i tyre e rrezon edhe deklaratën e F. I. e cila ka pohuar se këto aplikacione të pa regjistruara i ka futur në sistemin e shërbimit IT-së, por kjo dëshmitare e ka vërtetuar faktin se i akuzuari L. S. e ka ditur për gjendjen e aplikacioneve të të akuzuarve dhe përkundër faktit ka urdhëruar që këto të futën në sistem, me këtë edhe ka aprovuar që të bëhet pagesa e subvencioneve në dobi të këtyre fermerëve. Deklaratës së të akuzuarit L. S. nuk duhet ti falet besimi, e pikërisht pjesës ku ai thekson se

përgjegjësinë për kontrollin e aplikacioneve dhe miratimin e subvencioneve e kanë pasur studentët dhe praktikantët të cilët i kanë plotësuar aplikacionet me këtë deklaratë ai dëshiron ti shmanget përgjegjësisë penale, nga se rregullorja për përgjegjësitë, detyrat dhe kompetencat e AZHB-së në dispozitën e nenit 13 përcakton se vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve dhe miratimin dhe autorizimin e pagesave e bënë drejtorati për pagesa direkte, dëshmitarja M. B. ka theksuar se përgjegjësia bie mbi personin që ika miratuar pagesat dhe i ka vlerësuar të njëjtat, e sipas rregullores kjo ka qenë punë e të akuzuarit L. S.. Nga këto arsye konsideroj se në veprimet e të akuzuarit L. S. janë formuar të gjitha këto elemente të veprës penale. edhe deklaratave të të akuzuarve A. S.1 etj, që akuzohen për vepra penale të mashtrimit në subvencione dhe falsifikimit me dokumente, nuk duhet ti falet besimi, e sidomos që ata i ka mashtruar një Italian, kanë menduar se po marrin tokë me qira nga se ata kanë dështuar që të tregojnë emrin dhe identitetin e Italianit dhe të përkthyesit të tij, që të gjithë kanë ditur që janë duke aplikuar për subvencione e kjo më së miri shihet nga vërtetimet për tatimin e paguar lëshuar nga KK Suharekë për vitin 2015, ku në rubrikën qëllimi i lëshimit të certifikatës - vërtetimit qëndron konstatimi, aplikimi për subvencione, e të gjitha të akuzuarit në deklaratat e tyre kanë pohuar se këto vërtetime i kanë nxjerrë vetë, çka vërteton se ata kanë ditur se qëllimi i këtyre pagesave është subvencionimi i vreshtave ekzistuese, prandaj në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale mashtrim me subvencione dhe falsifikim të dokumentit. Të gjithë të akuzuarit konsideroj se janë të përgjegjës në aspektin penal juridik dhe i propozoj gjykatës që të gjithë ti shpallë fajtorë për veprat penale të cekura në aktakuzë dhe ti obligoj gjykata të akuzuarit që AZHB-së t'ia kthejnë mjetet, ndërsa të akuzuarit L. S. në kuptim të nenit 62 parag. 2.3 te KP-së ti shqiptoj edhe dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të profesionit - i veprimtarisë ose detyrës, në rastin konkret të detyrës së zyrtarit në institucionet publike.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar M. B. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar me shkrim. Në të cilën fjalë përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se Agjensia për zhvillimin e bujqësisë në ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, si implementuese e këtij organi është njoftuar me rastin nga departamenti i vreshtarisë dhe i verarisë të MBPZHR -së, me raport se disa fermer që kanë përfituar nga subvencionimi i vreshtave për programin 2015 nuk janë të regjistruar në regjistrin e fermerëve që administrohet nga ky departament, nën ndryshimin se këta aplikues/përfitues për subvencionimin për vreshta për programin 2015 në divizionin e pagesave direkte në AZHB kanë paraqitur të dhëna të rrejshme dhe kanë falsifikuar certifikatën e vreshtarit. AZHB-ja menjëherë ka marrë të gjitha masat e parapara ligjore për këtë rast, duke bërë super kontrolle dhe në bazë të raportit ka bërë kërkimin e kthimit të mjeteve të marrura, pasi që ka rezultuar se këta fermer nuk i kanë vreshtat për të cilat kanë marrë subvencion, në këtë mënyrë kanë shkëlur kushtin bazë të programit të pagesave direkte dhe udhëzimin administrativ për pagesa direkte, andaj edhe është iniciuar kjo procedurë penale ndaj tyre, duke paraqitur kërkesë për hetim të rastit dhe kërkesë pasurore juridike që rrjedhë nga kryerja e kësaj vepre penale e cekur në aktakuzë. Në këtë mënyrë është dëmtuar buxheti i R. së Kosovës dhe AZHB-ja si implimentuese është dëmtuar dy vite radhazi 2014 dhe 2015 nga këta persona të cilat pas kërkesës për kthim të bërë nga AZHB-ja, i kanë kthyer mjetet financiare të marrura në emër të subvencioneve për vitin 2015 por jo edhe për vitin 2014. AZHB duke parë që është dëmtuar buxheti i R. së Kosovës i ndarë për subvencione për fermerët që kanë vreshta, në vlerë totale prej 31,180.00 euro, prej tyre 15,520.00 të marrë në emër të subvencionit për vitin 2015 janë kthyer, kërkohmë nga trupi gjykues që 11 të

akuzuarit të shpallën fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit pasi që ka prova dhe argumente që të akuzuarit kanë marrë subvencion në kundërshtim me ligjin.

I akuzuari A. S.1 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi aktakuzën, nga se në aktakuzë shkruan, se unë i kam dorëzuar për vitin 2014 dhe 2015 në Komunë të Suharekës dokumentet për marrjen e subvencioneve, këto dokumente nuk i kam dorëzuar, nuk ekziston nënshkrimi im në këto dokumente të cilat janë paraqitur në Komunë, dokumentin të cilin e kemi nxjerrë të tatimit në pronë, shkruan se ky dokument nxjerrët për subvencione, këtë fakt e kam pranuar dhe pas marrëveshjes që kam pasur me italianin e kam marr këtë dokument dhe se për këto arsye nuk e ndiej veten fajtorë.

I akuzuari I. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari A. S.2 në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari E. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari V. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari A. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari L. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari Xh. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari Xh. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari L. T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

I akuzuari F. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem në tërësi me fjalën e parafolësit, nuk e ndiej vetën fajtorë dhe kërkoj nga gjykata që të me liroj nga aktakuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. S. av. N. R. fjalën përfundimtare gjykatës ia ka dorëzuar me shkrim, të cilën e ka elaboruar gojarisht dhe për veç fjalës përfundimtare me shkrim ka shtuar se sot në seancën e sotme pranuar fjalën përfundimtare nga prokurori i shtetit në formë të shkruar, të cilën prokurori i shtetit e elaboroj edhe gojarisht, çka në pritnim se prokurori i shtetit në bazë të procedurës së zhvilluar në shqyrtimin gjyqësor do të tërhiqej

nga aktakuza, sa i përket të akuzuarit L. S.. Mirëpo prokurori i shtetit kërkoj që i njëjti të shpallët fajtorë edhe pse nuk e argumentoj gjatë gjithë fazës së procedurës penale në gjykatë, por as gjatë fazës së hetimeve dhe tani në fjalën përfundimtare thuaj se është një kopje e aktakuzës, e cila aktakuzë që nga fillimi nuk ka përmbajtur dyshimin e bazuar mirë e që në shqyrtim gjyqësor prokurorja e shtetit do duhej ta argumentonte përtej dyshimit të bazuar mirë, se akuzuari L. S. ka kryer veprat penale që i vien në barrë. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ju referua disa nga deklaratave të dëshmitarëve në mënyrë selektive duke e deklaruar se diku, diku mund ti falej besimi deklaratave e në pjesë të tjera mos ti falej besimi, konkretisht përmend dëshmitaren F. I. nga deklarimi i së cilës prokurori nxjerrë vetëm një fjali e cila fjali shkon në favorin e L. S. ku thotë se vetë L. ka urdhëruar dëshmitarin të dërgoj lëndët që të futen në sistem tek teknologjia informative në anën tjetër konsiderojmë se prokurori i shtetit në këtë rast nuk ka paraparë edhe një detyrim ligjor që ka ndaj të pandehurit e si që parashihet në nenin 48 te KPP-së, ku ka obligim krahas fakteve dhe provave fajësuese të përpiqet të gjen fakt edhe prova shfajësuese, fjala përfundimtare e paraqiti edhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar që 11 të akuzuarit kërkoj që të shpallën fajtorë duke mohuar apo duke mos përmendur që edhe L. S. të shpallët fajtorë, vetëm e vetëm duke e ditur se a kishte L. përgjegjësi në këto subvencione, për më tutje do ti referohem fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim.

I akuzuari L. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe shtonë se që nga fillimi jam deklaruar i pa fajshëm, deklarohem edhe sot që jam i pa fajshëm, sepse nuk ka asnjë provë të vetme që mua që me inkriminon në këtë çështje penale, kërkoj nga trupi gjykues që të me shpallë të pa fajshëm dhe të më liron nga aktakuza.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe atë konform nenit 257 të KPP është kujdesur lidhur me pranueshmërinë e provave dhe se në rastin konkret nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme në këtë çështje penale dhe se pretendimet e mbrojtësve lidhur me pa pranueshmërinë e provave nuk qëndrojnë ngase në shqyrtimin e dytë është vendosur si nga kjo gjykatë dhe gjykata e shkallës së dytë se në këtë çështje penale nuk kemi të bëjmë me prova të pa pranueshme dhe se të gjitha provat që mbështetet akuza janë marr në pajtim me dispozitatat e KPP-së.

Për vërtetimin e gjendjes faktike për të akuzuarit tjerë gjykata i ka proceduar provat e propozuara nga palët dhe atë: dëgjimin e dëshmitarëve M. B., E. H., I. K., P. B., I. B., V. S., I. M., F. I., L. K., Xh. K. dhe N. M. si dhe provat material siqë janë aplikacioni nr. 136 për pagesa direkt për vreshtat ekzistuese, dt. 23.04.2014, në emër të A. S.1, certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71518081 dt. 16.04.2014, në emër të A. S.1, certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71518081 dt. 16.04.2014, në emër të B. C. dt. 23.06.2016, aplikacioni nr. 11914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese dt. 13.05.2015, në emër të A. S.1, certifikata e vreshtarit me nr. serik 72111038 dt. 07.05.2015, në emër të A. S.1, aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkte për vreshtat ekzistuese dt. 12.05.2015, në emër të I. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72110305 të dt. 05.05.2015, në emër të Gj. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72100002, të dt. 29.04.2015, në emër të N. S., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt për vreshtat ekzistuese dt. 12.05.2015, në emër të A. S.2, certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72110307 të dt. 30.04.2015, në emër të R. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72110685 te dt. 29.04.2015, në emër të H. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72110685 dt. 29.04.2015, në emër të H. S., aplikacioni me nr.19914 për pagesa direkt për vreshtat ekzistuese dt. 12.05.2015, në emër

të B. J., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 e dt. 07.05.2015, në emër të E. S., aplikacioni me nr. 1243 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 13.04.2014, në emër të E. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71518082 e dt. 11.04.2014, E. S., aplikacioni me nr.19914 për pagesa direkt për vreshtat ekzistuese dt. 12.05.2015, në emër të V. K., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71800128 e dt. 12.05.2015, në emër të S. K., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71800139 e dt. 20.05.2015, në emër të F. K., aplikacioni me nr. 1243 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 13.04.2014, në emër të V. K., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 13.05.2015, në emër të A. P., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 12.05.2015, në emër të L. P., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 e dt. 07.05.2015, në emër të L. P., aplikacioni me nr. 136 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 23.04.2014, në emër të L. P., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71518088 e dt. 15.04.2014, në emër të L. P., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 12.05.2015, në emër të Xh. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 e dt. 07.05.2015, në emër të Xh. R. S., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 12.05.2015, në emër të Xh. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 e dt. 07.05.2015, në emër të Xh. S., aplikacioni me nr. 137 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 25.04.2014, në emër të Xh. S., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 71518077 e dt. 12.04.2014, në emër të Xh. S., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 12.05.2015, në emër të L. T., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72111038 e dt. 07.05.2015, në emër të L. T., aplikacioni me nr. 19914 për pagesa direkt, për vreshtat ekzistuese të dt. 13.05.2015, në emër të F. H., certifikata e vreshtarit me nr. identifikues 72110829 e dt. 27.05.2015, në emër të Sh. (M.) H., raporti i kontrollit nga tereni i dt. 25.10.2016 në emër të H. B., harta e vreshtave in-aktive, orto fotot, raporti i listave krahasuesese të subvencionimit të vreshtave me nr. reference 07/4/35/2016 të dt. 15.03.2016 i përpiluar nga E. H., krye shef ekzekutiv i AZHB-së, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar E. S. nga AZHB-ja, dt. 27.06.2016, me nr. ref. 07/4/1/082/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar E. S. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/520/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar A. P. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/085/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar L. T. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/087/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar Xh. S. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/080/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar V. K. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/512/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar V. K. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/077/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar Xh. S. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/511/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar Xh. S. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/079/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar F. H. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/088/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar L. P. nga AZHB-ja dt. 27.06.2016 me nr. ref. 07/4/1/517/2016, verifikimi i fermerëve në sistem e lëshuar nga AZHB- I. K.-shef i Divizionit IT dhe regjistrave dt. 17.10.2016, përgjigjja në kërkesën e Policisë nga Xh. K. – drejtor i DPZHBP në Suharekë, me nr. 08-nr.-127/16 dt. 16.05.2016, kërkesa për hetimin e rastit e dt. 15.03.2016 e parashtruar nga krye shefi ekzekutiv i AZHB-së, E. H., gjashtë (6) flet kthesave të dërgesave me postë në emër të E. S., A. S.1, V. K., Xh. S., L. P., A. B., kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar I. S., dt. 15.03.2016, me nr. ref. 07/4/1/086/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar A. S.2, dt. 15.03.2016, me nr. ref. 07/4/1/081/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar A. P., dt. 15.03.2016, me nr. ref.

07/4/1/085/2016, kërkesa për kthimin e mjeteve financiare drejtuar L. P., dt. 15.03.2016, me nr. ref. 07/4/1/084/2016, shkresat e AZHB-së, " Përzgjedhja e mostrës për kontrolle në teren për pagesa direkt për vitin 2015 me nr. ref. 07/4-575 dt. 04.03.2015", informata për PD subvencionet, vreshtat 2015-2014 nga Agjencia për zhvillimin e Bujqësisë – E. H. – krye shef ekzekutiv, 07/4 me nr. 4183, dt.27.10.2016, raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 011324 për F. H., raporti e kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 011323 në emër të L. T., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 011325 në emër të I. S., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 011326 në emër të A. S.1, raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 11.03.2016, me nr. 000631 në emër të E. S., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 11.03.2016, me nr. 000629 në emër të Xh. S., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 11.03.2016, me nr. 000630 në emër të Xh. S., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr.000632 në emër të A. S.2, raporti i kontrollit për pagesa direkte i dt. 14.03.2016, me nr. 000367 në emër të A. P., raporti i kontrollit për pagesa direkte i dt. 14.03.2016, me nr. 000366 në emër të L. P., raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 000365 në emër të V. K. si dhe mbrojtjet e të akuzuarve.

Dëshmitarja M. B. në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se punon si zyrtare e lartë ligjore në divizionin e AZHB-në, në agjencinë ku punoj vit për vit ndahen subvencionet për bujqit, vreshtarët dhe degë tjera të bujqësisë me qëllim të zhvillimit të këtyre sektorëve të bujqësisë. Mënyra se si aplikohet për subvencione nga ana e vreshtarëve në rastin konkretë, vit për vit rregullohet me udhëzim administrativ, në rastin konkretë kemi të bëjmë me subvencionet e keqpërdorura të cilët kanë qenë të destinuara për vreshtarët për vitin 2015 dhe 2014. Gjithë herë aplikacionet ndahen nëpër komuna dhe bujqit aplikojnë nëpër komuna respektivisht në drejtoritë për bujqësi të komunës përkatëse. Këto aplikacione i pranojnë zyrtarët komunal dhe obligimi i tyre është të vërtetojnë se a është dokumentacioni në rregull, ndërsa sipas nenit 27 parag. 4 të udhëzimit administrativ me nr. 02/2015 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2015 parashihet që aplikuesi me nënshkrimin e tij siguron të gjitha informatat e dhëna të jenë të qarta të besueshme dhe ai do të lejon kryerjen e kontrollit në teren nga kjo nënkuptohet se përgjegjësinë për vërtetësinë të dokumenteve të bashkangjitura e bartë personi që aplikon. Pasi që mblidhen të gjitha aplikacionet, dorëzohen në AZHB në divizionin për pagesa direkt, i cili bënë kontrollimin administrativ të dokumenteve. Ndërsa verifikimin në teren e bënë divizioni i kontrollit dhe atë sipas politikës të cilën e përcakton divizioni pagesave direkt. Sa i përket këtyre subvencioneve të keqpërdorura të gjithë vreshtarët për vitin 2015 i kanë kthyer subvencionet, ndërsa në vitin 2014 nuk i kanë kthyer. Në realitet kur divizioni i pagesave ka marrë konfirmim se këta persona nuk janë vreshtar, ka bërë një kontrolle të jashtëzakonshëm ose super kontroll dhe ka vërtetuar se këta nuk janë vreshtar, pra nuk kanë vreshta.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares M. B., gjykata vlerëson se AZHB vit për vit ndan subvencione për bujqit, vreshtarët dhe degë tjera të bujqësisë me qëllim të zhvillimit të këtyre sektorëve të bujqësisë. Mënyra e aplikimit vit për vit rregullohet me udhëzim administrativ. Aplikacionet i pranojnë zyrtarët komunal dhe se obligimi i tyre është që të vërtetojnë se a është dokumentacioni në rregull ndërsa sipas nenit 27 parag. 4 të udhëzimit administrativ me nr. 02/2015 për pagesa direkt në bujqësi për vitin 2015 parashihet që aplikuesi me nënshkrimin e tij siguron të gjitha informatat e dhëna të jenë të qarta të besueshme dhe ai do të lejon kryerjen e kontrollit në teren nga kjo nënkuptohet se përgjegjësinë për vërtetësinë të dokumenteve të bashkangjitura e bartë personi që aplikon.

Të gjitha aplikacionet dorëzohen në AZHB në divizionin e pagesave direkt dhe se ky divizion bënë verifikimin e dokumentacionit. Në vitin 2014 dhe 2015 ka pasur keqpërdorime të subvencioneve dhe me të marr informatën se këta përfitues të subvencioneve nuk janë vreshtar, divizioni i pagesave direkte ka bërë super kontroll dhe ka vërtetuar se këta persona kanë keqpërdorur subvencionet. Nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se në vitin 2014 dhe 2015 ka pasur keqpërdorime të subvencioneve, këto keqpërdorime janë evidentuar pas super kontrollit të bërë nga AZHB. Kjo dëshmi përkon edhe me provat materiale të administruara për të akuzuarit të shpallur fajtorë. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitari E. H. në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se fillimisht fermeri i këtij sektori duhet që të pajiset me certifikatë të vreshtarisë, tash të departamentit të vreshtarisë dhe të vertarisë, pas kompletimit të dokumentacionit, ai aplikon në komunën përkatëse të cilës i takon, kurse pas kësaj periudhe shqyrtimin e këtyre aplikacioneve ka bërë divizioni i pagesave direkte subvencione, numri i aplikacioneve është shumë i madh kurse resurset njerëzore janë në mangësi në atë divizion dhe nuk kemi kapacitete me vërtetu një dokument a është i falsifikuar a nuk është i falsifikuar deri në atë masë, numri i aplikacioneve për person që kanë me trajtua për personin zyrtar është i madh tek ky divizion, kjo mbetet tek pjesa administrative të cilët e kanë kontrolluar si dosje dhe është vështirë të identifikohet një dokument si që kanë qenë certifikatat e falsifikuara nga fermerët. Përgjegjës për lejimin e subvencioneve është divizioni i pagesave direkte, personi që ka trajtuar lëndët dhe se mbikëqyrës ka qenë Luan Statovci në atë kohë. Çdo fermer është i obliguar që të ketë NIF (numri identifikues i fermerit), ndërsa nuk me kujtohet si detaj por e di se fermeri patjetër duhet të ketë NIF. Ndërsa për certifikatat e vreshtarëve nuk e di se a kanë numër të veçantë por besoj se duhen të kenë, ai departament është i veçantë dhe se unë nuk e di saktë. Më herët desha me cek që punët teknike i kryejnë zyrtarët domethënë realisht direkt nuk e trajton si lëndë Luan Statovci, lënda trajtohet nga zyrtari i lëndës, i cili e trajton lëndën dhe është përgjegjës për komunën përkatëse dhe sektorin përkatës, L. S. ka qenë përgjegjës i këtyre sektorëve. Kontrollin në teren bazuar në përqindjen e kontrollit në teren i cili përcaktohet në udhëzimin administrativ nga ministria e bujqësisë, kurse ne si agjencion jemi implementues i këtyre politikave të cilat i bënë ministria, domethënë nuk kontrollohen 100%, diku mesatarisht kontrollohen rreth 50% të sektorëve rëndësi i dhanë çdo vit të sipërfaqeve të mëdha dhe ato janë prioritet, psh te sipërfaqet e grurit mbi 5 hektar kontrollojmë 100% se është rreziku i madh dhe ka mjete shumë kurse këtu mbi 2 hektar këto i kontrollojmë përafërsisht 50%, sepse numri është i madh i aplikacioneve. Në rastin konkretë para se të ndahen subvencionet nuk është bërë kontrolli në teren, dhe se pas një shkresë zyrtare nga departamenti i vreshtarisë dhe vertarisë, si ekzekutiv kam marrë masa dhe kam bërë kontrollin dhe kemi bërë kërkesë për kthyerjen e mjeteve për keqpërdorim të subvencioneve.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit E. H., gjykata vlerëson se ky dëshmitar është krye shef i AZHB-së. Fillimisht fermeri duhet të pajiset me certifikatë të vreshtarisë apo vertarisë, ta kompletojë dokumentacionin dhe ta dorëzojë pranë komunës përkatëse. Këto aplikacione pranohen nga AZHB - divizioni i pagesave direkte, numri i aplikacioneve është i madh ndërsa resurset njerëzore janë në një numër të vogël në atë divizion, këto aplikacione kontrollohen nga zyrtarët teknik të këtij divizioni dhe se direkt nuk trajtohen lëndët nga mbikëqyrësi L. S. Kontrolli në teren bëhet sipas udhëzimit administrativ të ministrisë së

bujqësisë, kurse si agjencion AZHB janë implementues të këtyre politikave të cilat behën nga ministria. Nuk kontrollohen 100%, diku mesatarisht kontrollohen rreth 50% të sektorëve, çdo vit kontrollohen sipërfaqet e mëdha dhe se ato janë prioritet, "psh te sipërfaqet e grurit mbi 5 hektar kontrollohen 100% ku mund të ketë rrezik të madh për shkak të mjeteve të mëdhaja ndërsa në pjesët mbi 2 hektar kontrollohen 50% sepse numri është i madh i aplikacioneve dhe se në rastin konkret para se të bëhet ndarja nuk është bërë kontrolli në teren dhe pas marrjes së shkresës zyrtare për keqpërdorim, atëherë është dhënë urdhër për super kontroll. Kjo dëshmi përkon me dëshminë e dëshmitares Manushaqe Bytyqi si dhe me provat materiale të administruara për të akuzuarit të shpallur fajtorë. Por edhe me këtë dëshmi nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin Luan Statvoci. Nga kjo dëshmi është vërtetuar fakti se AZHB divizioni i pagesave direkte ka pasur mungesë në resurset njerëzore dhe se aplikacionet janë verifikuar nga stafi teknik të angazhuar nga studentet dhe praktikantët dhe se direkt lëndët nuk trajtohen nga i akuzuari Luan Statvoci.

Dëshmitari I. K. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se punon si shef i divizionit të teknologjisë informative dhe regjistra. Sa i përket vreshtave ekzistuese, vreshtat kanë filluar të digjitalizohen për herë të parë gjatë vitit 2015, gjatë kësaj kohe ne i mbështesim zyrtaret komunal për digjitalizimin e parcelave që aplikojnë fermerët për subvencione, zakonisht ka ankesa që nuk mund të orientohen në parcela, ka probleme edhe kur dy fermerë tentojnë të aplikojnë për të njëjtat sipërfaqe, sistemi nuk e lejon këtë. Në momentin kur nuk lejohen aplikacionet për dy fermerë të futet parcela e njëjtë, këta fermerë mbesin pa aplikuar. Për vitin 2014 nuk kam qenë i involvuar gjatë aplikimit, pasi që nuk është aplikuar përmes sistemit LPIS, vetëm gjatë vitit 2015 është aplikuar sistemi LPIS, për zhvillimin e sistemeve ne kemi qenë të mbështetur nga bashkimi evropian dhe projekt i "danidës" dhe për herë të parë është bërë digjitalizimi i vreshtave gjatë kësaj kohe, pas mbylljes së kampanjës për aplikim është bërë importimi i të dhënave nga LPIS në grand menaxhment në modulën e menaxhimit të aplikacioneve në mënyrë automatike, gjatë kontrollit të aplikacioneve zyrtarët e pagesave direkte kanë ngritur shqetësim apo ankesë se një pjesë e aplikacioneve mungojnë në modulën e pagesave direkte, programi i atëhershëm ka vërejtur se nuk janë importuar këto aplikacione për shkak se ne zyrtarët komunal gjatë aplikimit në LPIS nuk është plotësuar adresa e fermerit dhe kjo ka qenë problemi i mos plotësimi i aplikacionit. Programeri i modulit të pagesave direkte ka kontaktuar me programerin e LPIS ku programeri i LPIS është shtetas gjerman, i cili ia ka lëshuar qasjen për importimin e këtyre fermerëve që i ka munguar adresa, për importimin e të dhënave ka rregullta strikte në rastin konkret 12 fermerët nuk gjenden në LPIS, vetëm njeri është i regjistruar në regjistrin e fermerëve dhe ai është Iljaz Sopi me datën 28.12.2012 në ora 11:20 minuta, ky fermerë është regjistruar në Komunën e Prizrenit prej zyrtarit komunal J. K. kjo nuk ka të bëjë me aplikim. Çdo aplikacion merr numër të veçantë dhe ai është unik, nuk mund me të njëjtin numër të jenë dy aplikacione. Përveç këtyre fermerëve ka edhe fermerë tjerë që nuk janë regjistruar në LPIS por numrin e tyre nuk mund ta di, për shkak se aplikohet në të gjitha komunat e Kosovës dhe ata fermerë mbesin të pa regjistruar në rastet kur tentohet të aplikohet për të njëjtën parcelë, apo mund të ketë mbulim të parcelës njëra me tjetrën që aplikohet, nëse ka mbulesë vetëm një përqind mund të them ai aplikacion jetë jashtë sistemit, ka raste kur zyrtari komunal nuk e mbyllë aplikacionin edhe ky jetë jashtë sistemit, ka raste kur zyrtaret komunal për shkak të ndonjë gabimi dërgojnë email IT-së për rihapjen e aplikacionit, do të thotë pas kësaj zyrtari komunal shpesh ndodhë që me mbyll aplikacionin.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit I. K., gjykata vlerëson se ky dëshmitar është shef i teknologjisë informative. Në vitin 2014 nuk është aplikuar sistemi i LPIS dhe se ky sistemi është aplikuar në vitin 2015 dhe se qëllimi ka qenë i digjitalizimit të parcelave. Në vitin 2015 i ka mbështetur zyrat komunale në kohën e aplikimit për subvencione nga fermerët. Programi LPIS ka rregulla strikte. Problemet paraqiten kur dy fermerë aplikojnë për sipërfaqen e njëjtë pasi që sistemi nuk e lejon këtë. Në rastin konkret 12 të akuzuarit nuk gjenden në këtë sistem përveç të akuzuari I. S. dhe se ky është regjistruar në zyrën komunale në Prizren. Pas mbylljes së kampanjës për aplikim është bërë importimi i të dhënave nga LPIS në grand menaxhment në modulën e menaxhimit të aplikacioneve në mënyrë automatike, gjatë kontrollit të aplikacioneve zyrtarët e pagesave direkte kanë ngritur shqetësim apo ankesë se një pjesë e aplikacioneve mungojnë në modulën e pagesave direkte. Nga kjo dëshmi është vërtetuar fakti se gjatë kontrollimit të aplikacioneve kanë ngritur shqetësim apo ankesë se një pjesë e aplikacioneve mungojnë në modulën e pagesave direkte, kështu që ky divizion ka lypur informata se pse nuk janë të evidentuara këto në sistem. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitari P. B. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se punon në mirëmbajtjen e rrjetit në sektorin e shërbimit - mirëmbajtjen e kompjuterëve, printerëve etj, pranë AZHB-së, dhe se këtë detyrë e kryen që nga 1 tetori 2012. Sa i përket problemeve me sistem prej fillimit të punës nuk kemi pasur probleme me program, faktikisht aty janë dy programe dhe WEB site që e mirëmbajnë. Për futjen e aplikacioneve në sistem e bënë departamenti tjetër ndërsa ne nuk merremi me futjen e të dhënave në sistem. Sa i përket gabimeve teknike, zyrtarët komunal me shkresë zyrtare kërkojnë që të bëhet ndonjë përmirësim i ndonjë gabimi teknik dhe se formohet komision për përmirësimin e ndonjë gabimi dhe në fund ky komision bënë edhe raport për punën e bërë. Çdo aplikacion ka numër të veçantë - numër unik dhe nuk mund të jetë i njëjtë me një dokument tjetër. Në vitin 2014 AZHB-ja nuk ka pasur sistemin e LPIS.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit P. B., gjykata vlerëson se ky dëshmitar punon si mirëmbajtës i rrjetit pranë AZHB - së. Futjen e të dhënave në sistem e bënë departamenti tjetër. Kurse sa i përket gabimeve teknike, zyrtarët komunal i drejtohen me shkrim për ndonjë gabim eventual dhe se korigjimi i gabimit bëhet me komision dhe se komisioni përpilon raport për punën e bërë. Dhe se edhe me këtë dëshmi është vërtetuar fakti se në vitin 2014 nuk ka qenë sistemi i LPIS. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitari I. B. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se H. M. B. e ka baba, jeton në fshatin K., K. e Suharekës, dhe se kanë vreshta në pronësi të familjes dhe se kanë aplikuar një herë për subvencione, sa me kujtohet në vitin 2014 axha ka aplikuar për subvencione dhe ka fituar dhe pas vitit 2014 kemi aplikuar por nuk kemi fituar, asnjëherë këto vreshta nuk i kemi dhënë me qira, e as ti kemi dhënë dikujt në shfrytëzim certifikatat e vreshtarit, personin A. B. nuk e njoh.

Duke vlerësuar dëshminë e dëshmitarit I. B. është vërtetuar se si familje vetëm njëherë kanë qenë përfitues të subvencioneve dhe atë prej vitit 2014 kanë aplikuar për subvencione dhe se asnjëherë nuk kanë qenë përfitues. Është vërtetuar edhe fakti se asnjëherë nuk kanë dhënë vreshtat me qera e as ti kanë dhënë ndokujt në shfrytëzim

certifikatat e vreshtarit. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara dhe se nga kjo dëshmi vërtetohet fakti se certifikatat e vreshtarit janë falsifikuar nga të akuzuarit me qëllim të përfitimit të subvencioneve.

Dëshmitarja V. S. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se punon në mirëmbajtjen e infrastrukturën e teknologjisë informative dhe rrjetit të brendshëm apo intra net pranë AZHB-së dhe se që nga 17.03.2014 punon në këtë departament, fillimisht si punëtore e re nuk ka pasur qasje në sistem, kryesisht ka përcjellë punën se si punohet, në kampanjën e vitit 2014 nuk ka pasur qasje në sistem. Gjatë punës primare e ka që të mirëmbaj aparaturat, gjatë kampanjës për aplikim për subvencione i mbështesin zyrtarët komunal, kur kanë ata ndonjë problem, dhe se kontakti bëhet përmes imeit zyrtar. Si çdo vite gjatë kampanjës edhe në vitin 2015 kemi hasur në probleme, ky për faj ose të zyrtarit komunal që bënë gabim teknik ose ka pasur diçka probleme me rrjetë dhe nuk janë ruajtur të dhënat. Aplikacionet mbushën në zyrat komunale apo regjionale, fermeri mund të regjistrohet në këtë zyre komunale dhe regjionale dhe se këto aplikacione vinë në AZHB, por ne nuk kemi qasje në këto aplikacione. Asnjë aplikacion nuk mund të futët në sistem pas kampanjës dhe se me vetë faktin e mbylljes së kampanjës mbyllët edhe sistemi.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares V. S., gjykata vlerëson se kjo dëshmitare punon në mirëmbajtjen e infrastrukturën e teknologjisë informative dhe rrjetit të brendshëm apo intra net pranë AZHB-së. Gjatë kampanjës e njëjta ndihmon zyrat komunale që gjatë futjes së të dhënave në sistem mund të ketë ndonjë gabim eventual dhe se kontakti me këto zyra është bërë përmes imeit zyrtar. Si çdo vit edhe në vitin 2015 kanë pasur probleme teknike gjatë ruajtjes së të dhënave. Kjo dëshmitare nuk ka qasje në aplikacione ngase aplikacionet mbushen nga zyrat komunale. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitari I. M. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se që nga data 26.03.2013 punon në AZHB dhe se detyrat e tij janë mirëmbajtja e rrjetit, mbështetja e zyrtarëve komunal gjatë kampanjës për aplikim, për subvencione etj. Përveç mirëmbajtjes së rrjetit, përgjegjës për sistemin data baza është përgjegjësi - shefi I. K. Gjatë vitit 2014 dhe 2015 kam mbështetë zyrtarët komunal për aplikim për subvencione dhe se sa me kujtohet në vitin 2014 vreshtat nuk kanë pasur sistem, në vitin 2015 si për grurë, si për misër, aplikimi ka qenë i njëjte. Gjatë vitit 2015 nuk me kujtohet që të ketë pasur probleme me sistemin, dhe se po të kishte ekzistuar problemi nuk do të ishte e mundur të aplikohet, për vitin 2014 nuk e di se si është bërë aplikimi. Çdo fermerë kur bënë aplikimin ai duhet të ketë numrin identifikues të fermës, shkurtë thirrët NIF dhe pa këtë nuk mund të aplikohet, çdo fermerë ka një numër identifikues dhe nuk guxon të përsëritet ai numër. Ka aplikacione që mbesin jashtë sistemit që kanë gabime teknike, kjo mund të ndodhë atëherë kur dy fermerë pretendojnë se janë pronar të njëjtës parcelë, aplikuesi i parë konsiderohet si aplikues i rregullt, dhe deri në momentin kur vërtetohet se cili ka të drejtë.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit I. M., gjykata vlerëson se punon në AZHB dhe se detyrat e tij janë mirëmbajtja e rrjetit. Për çdo vit i mbështet zyrat gjatë kampanjës lidhur me subvencione. Çdo fermerë kur bënë aplikimin ai duhet të ketë numrin identifikues të fermës, shkurtë thirrët NIF dhe pa këtë nuk mund të aplikohet, çdo fermerë ka një numër identifikues dhe nuk guxon të përsëritet ai numër. Ka aplikacione që mbesin jashtë sistemit që kanë gabime teknike, kjo mund të ndodhë atëherë kur dy fermerë

pretendojnë se janë pronar të njëjtës parcelë, aplikuesi i parë konsiderohet si aplikues i rregullt, dhe deri në momentin kur vërtetohet se cili ka të drejtë. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitarja F. I. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se gjatë vitit 2015 e ka bërë kontrollimin administrativ të dosjeve të fermerëve që kanë aplikuar për vreshta. Gjatë kontrollimit të dosjeve dhe mund të them se çdo dosje e tretë nuk ka dalë në sistem, e kemi lënë anash, kur janë bërë disa dosje kemi shkuar të IT dhe i kemi treguar problemin, IT nuk kanë sugjeruar që të kompletojmë të gjitha dhe tia dërgojmë kompletë, nuk e di se aplikacionet kanë qenë me numra, kanë qenë me emër dhe mbiemër dhe se në sistem e kemi kërkuar përmes emrit, mbiemrit ose numrit të NIF-it. Gjatë kontrollimit të dosjes sa me kujtohet se certifikata e vreshtarit është kontrolluar me dokumentet të tjera përcjellëse dhe se unë personalisht nuk kam pasur asnjë rast që një certifikatë e vreshtarit të përdorët me dy emra.

Duke analizuar e dëshmitares F. I. është vërtetuar fakti se e njëjta ka bërë kontrollin administrativ të dosjeve të fermerëve që kanë aplikuar për vreshta. Gjatë kontrollimit ka hasur tek çdo e treta aplikacion që nuk ka qenë e regjistruar në sistem dhe pas konsultimit me IT, të njëjtit iu kanë sugjeruar që pas përfundimit atëherë dosjet që nuk janë në sistem të ju a dërgojnë me qëllim të futjes në sistem. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Dëshmitari L. K. në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se në vitin 2014 ka punuar në bartjen, kontrollin administrativ tek përzgjedhja e aplikacioneve, por nuk është bërë programi administrativ, është bërë në exel dhe nuk ka shkuar asgjë përmes programit dhe se gjatë kësaj pune nuk kam vërejtur ndonjë parregullsi. Por e di se kontrollimin administrativë dhe regjistrimin në exel të aplikacioneve për vitin 2014 e kanë bërë praktikantët. Dhe se vendimi përfundimtar pas kontrollimit administrativë merret prej zyrtarit që e ka përcjellë deri tek shefi vendimi për pagesë për një fermerë merret nga zyrtari, ndërsa si listë në tërësi vendo shefi i pagesave direkte në këtë rast L. S., ky i fundit vetëm i autorizon dhe së fundmi kjo procedurë autorizohet nga shefi sipas hierarkisë në fund autorizohet prej krye shefit, dhe se fundi personi i fundit që e autorizon pagesën e subvencioneve është krye shefi.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit L. K., është vërtetuar fakti se në vitin 2014 ka punuar në bartjen, kontrollin administrativ tek përzgjedhja e aplikacioneve, në vitin 2014 nuk është punuar në sistem dhe e gjitha puna është bërë në Exeln dhe se gjatë punës nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi dhe gjatë këtij viti kontrollimin administrativë të aplikacioneve e kanë praktikantët. Vendimi përfundimtar merret nga zyrtari që e ka bërë kontrollimin dhe si listë shkon tek shefi i pagesave direkte dhe personi i fundit që e autorizon pagesën është krye shefi i AZHB-së. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara. Por në asnjë pjesë të kësaj dëshmie nuk vërtetohet asnjë fakt apo element të veprës penale keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për të akuzuarin L. S.

Nga raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr.000632 në emër të A. S.2, është vërtetuar se tek i akuzuari është bërë super kontrolla e cila ka rezultuar se i akuzuari në bazë të dokumentacionit të dhënë nuk posedon vreshtë. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin kësaj prove, ngase me këtë provë vërtetohet gjendja faktike.

Nga raporti i kontrollit për pagesa direkte i dt. 14.03.2016, me nr. 000367 në emër të A. P., është vërtetuar se tek i akuzuari është bërë super kontrolla e cila ka rezultuar se i akuzuari në bazë të dokumentacionit të dhënë nuk posedon vreshtë. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin kësaj prove, ngase me këtë provë vërtetohet gjendja faktike.

Nga raporti i kontrollit për pagesa direkte i dt. 14.03.2016, me nr. 000366 në emër të L. P., është vërtetuar se tek i akuzuari është bërë super kontrolla e cila ka rezultuar se i akuzuari në bazë të dokumentacionit të dhënë nuk posedon vreshtë. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin kësaj prove, ngase me këtë provë vërtetohet gjendja faktike.

Nga raporti i kontrollit për pagesa direkt i dt. 14.03.2016, me nr. 000365 në emër të V. K., është vërtetuar se tek i akuzuari është bërë super kontrolla e cila ka rezultuar se i akuzuari në bazë të dokumentacionit të dhënë nuk posedon vreshtë. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin kësaj prove, ngase me këtë provë vërtetohet gjendja faktike.

I akuzuari A. S.1 në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se në vitin 2014 në tre mujorshin e parë të këtij viti, në zyrën time ka ardhur një italian së bashku me një përkthyes, kam pasur bindjen se përkthyesi është shtetas i R. së Shqipërisë, nga se fliste me dialektin e Shqipërisë, me kanë propozuar që të lidhi kontratë me ta për me marrë tokën e cila ishte për ballë lokalit tim ku unë punoj, duke me treguar që do të kem përfitime nëse e marrë atë tokë me qira, toka është në vendin e quajtur T., unë kam pas dëshirë që të kultivoj mjedra, kështu jemi marrë vesh që unë ta marrë një pjesë të asaj toke me qira për ti kultivuar mjedrat. Një pjesë e asaj toke ka qenë e mbjellur me rrush, pra ka qenë vreshtë, ndërsa pjesa tjetër ka qenë e dëmtuar. Kështu ai Italiani nëpërmes përkthyesit me ka thënë se do ta parcelizon pjesën të cilën unë do ta marrë me qira, dhe po qe se vendosi të mbjelli diçka aty, do të kem sukses nga se ai kam me ndihmuar dhe ka mundësi që të marrë edhe subvencione nga shteti për këtë. Kështu nga unë ka kërkuar kopjen e kartelës bankare, pra numrin e xhirlogarisë dhe vërtetimin që e

kam tatimin e paguar në pronë. Unë ia kam dhënë këto dy dokumente, pra vetë nuk kam aplikuar, nuk kam nxjerrë ndonjë dokument tjetër, dhe nuk kam ditur që ai do të aplikoj në emrin tim për të marrë subvencione për vreshta ekzistuese. Pas një kohe në konton time kanë arritur mjetet në emër të subvencioneve mjetet kanë qenë në shumë prej 2700 euro. Prej atyre mjeteve të cilat i kam tërhequr, 500 euro i kam mbajtur për vete ndërsa parat tjera ia kam dhënë Italianit, nga se ai me ka thënë që me ato para do të investon në atë tokë. Sa i përket vitit 2015 unë i kam paguar këtij Italianit para sa të më dalin subvencionet 500 euro për hektar në emër të qeras, prej asaj kohe ma unë nuk e kam pa këtë person. Përsëri kanë ardhur subvencionet në llogarinë time, unë kam marrë shumën prej 1530 euro, dhe pas një kohe pasi që ministria i ka kërkuar ato para, i kam kthye. Unë merrem me suvatim dhe izolimin e shtëpive. Të gjithë të akuzuarit tjerë i njoh pos të akuzuarit A. B.

I akuzuari I. S. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se një Italian ka shkuar tek A. S.1 në T. në lokalitë e tij, për ballë vreshtave, i ka kallxuar A. se nëse marrim tok me qira prej tij, ai do të na ndihmojë që në ato toka të mbjellim mjedra, kështu prej nesh ka kërkuar fotokopjen e kartelës së bankës dhe vërtetimin mbi tatimin e pagimit në pronë, këto dokumente të fotokopjuara se bashku me 500 euro, unë ia kam dorëzuar Italianit në lokalitë e A., bile e kam futur edhe djalit tim A. edhe kartelën e tij ia kam fotokopjuar dhe i kam dhënë 500 euro, për të, kështu edhe unë edhe A. kemi fituar 1330 euro, nuk kemi nënshkruar ndonjë kontratë, parat e marra i kemi kthyer. Unë punoj me instalimin e nxemjeve qendrore dhe mjetit sanitar, asnjëherë personalisht nuk jam marrë me vreshtari. Kam dëgjuar që kultivimi i mjedrave është shumë kontrivabil, kështu që kam pasur në plan që vetë ti mbjelli ato, vet ti blej fidanët dhe vet ti kultivoj, marrëveshje me dikën nuk kam pasur nga se ma aq sa di unë dy vite duhet të kalojë që fidani i mjedrës të prodhojë mjedra, me Italianin bisedojshim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

I akuzuari A. S.2 në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se ka pranuar në xhirollogarinë e tij shumën prej 1330 euro, dhe këto të holla ia ka dorëzuar A. S.1 që t'ia dërgon babait tim i cili në atë kohë ishte në Maqedoni. Unë nuk kam aplikuar për këto subvencione, babai im I. S. ka kërkuar nga unë numrin e xhirollogarisë bankare, të cilin ia kam dhënë, por kartelën nuk ia kam dhënë kështu si ka aplikuar ai nuk e di. Parat i ka kthyer në agjencion baba im I. A. S.1 e njoh si shok i babait. Personat me emrin Gj. R. S. dhe N. A. S. nuk i njoh.

I akuzuari E. S. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se me ka lajmëruar axha im A. se një Italian dhe një person nga Shqipëria po ofrojnë me lidh një kontratë për qiranë e tokës dhe se ka mundësi me marrë subvencione për atë tokë, kështu unë e kam nxjerrë certifikatën e pagimit të tatimit mbi pronën dhe kam fotokopjuar kartën bankare, ia kam dhënë axhës tim A. mandej ai ia ka dhënë këtyre dy personave, kjo ka ndodhë në vitin 2014. Ndërsa në vitin 2015 unë deri sa kam qenë në Mal të Zi dokumentet dhe procedurat tjera mika rregulluar axha im A. S.1 Gjithashtu pasi që ka kërkuar agjencionin parat i ka kthyer axha im A. S.1, po ashtu parat i ka marrë në atë kohë axha im nga bankomatit nga se e ka pas kartelën time të kredisë dhe e ka ditur pinin e kartelës. Në vitin 2014 i kam marrë 500 euro nga e gjithë shuma totale të tjerat i ka marrë Italiani, ndërsa për herë të dytë parat i ka marrë axha im nga bankomati dhe i ka kthyer, kur janë kthyer këto parat unë kam qenë në Kosovë. Fillimisht ky Italiani nga ka thënë që do ta parceloj tokën do t'ia vendos megjë me gardhë dhe pastaj unë kam pas plan ta kultivoj hardhinë e rrushit ne to se bashku me agjën tim A. S.1

I akuzuari V. K. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se jam punëtor që punoj në firmën A. S.1, zyrën e firmës e ka në fshatin T.. A. na ka treguar që ka një oferte prej një Italiani me i marr do toka me qira dhe ato toka me i punua pastaj që për punimin e atyre tokave do të fitojmë edhe benificion, kështu unë i kam dhënë vërtetimin mbi pagimin e tatimit në pronë dhe fotokopjen e kartelës së bankës A., pas një kohe parat kanë dalur në xhirollogarinë time, prej atyre parave ja kam qar A. 500 euro, mi ja dhënë Italianit i cili i kishte kërkuar ato, e të cilin nuk e njoh. Në vitin 2015 kam marrë këtë lloj ndihme prej 1330 euro, dhe ato para menjëherë ia kam dhënë A. S., nga se nuk e kam ditur ka me kanë ardhur, pastaj kur e kam kuptuar që janë subvencione i kam marrë dhe me vonë i kam kthyer në ministri. Nuk e di se kush e ka përgatitur aplikacionin, personalisht nuk kam aplikuar, ndërsa tokën nuk kam mundur me e punuar për shkak se ka pasur probleme në mes fshatareve të fshatrave rreth asaj prone.

I akuzuari A. P. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se 500 euro, ia kam dhënë Italianit duke menduar se po jam qiranë për tokën, unë kam pas plan në atë tokë që e marrë me qira nga Italiani të mbjelli mjedra , nuk e kam ditur se subvencioni është për vreshta ekzistuese. Italiani nga ne ka kërkuar vetëm certifikatën mbi pagimin e tatimit në pronë dhe numrin e xhirollogarisë bankare. Italiani dhe personi i cili ka qenë me te unë nuk e njoh, kam biseduar me A.2 dhe A.1 me ka thënë se a po donë me hy në këtë punë, ku dhe unë kam pranuar. Në fund deklaroi se mjetet të cilat i kam marrë i kam kthyer në ministri.

I akuzuari L. P. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se nuk kam nënshkruar kurrfarë kontrate lidhur me këto prona, fillimisht jam takuar me Italianin dhe me përkthyesin e tij dhe se A.1 me ka njoftuar që ka të bëjë me marrjen e tokës me qira. Në vitin 2014 kur me kanë ardhur të hollat në emër të subvencionit e kam kuptuar për mes SMS së bankës dhe se edhe për vitin 2015 e kam parë në xhirollogarinë time se këto të holla janë deponuar, 500 euro nga këto të holla i kam marrur unë ndërsa të tjerat i kam lënë në lokalin e A. S.1 Nuk kam pasur qasje në këto toka për shkak se fillimisht është dashur ti ndaj pronat Italiani e pastaj ne te fillojmë kultivimin dhe se kjo tokë ka qenë përballë të A.1 në T., unë nuk e di se kush ka aplikuar në Komunë për përfitimin e subvencioneve për mua.

I akuzuari Xh. S. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se unë jam viktimë, unë Italianin nuk e kam parë kurrë, e as që kam kontaktuar me te, mua A.1 me ka treguar për këtë ofertë që Italiani po e bënë me marrë tokë me qira, ka qenë toka përballë lokalit ku i ka zyrat A.1 në fshatin T., në bisedë e sipër me A.1 me është dukur ofertë e mirë që unë të filloj të kultivoj në atë tokë hardhi ose mjedra, 500 euro e kam dhënë në emër të qira, në bankë me kanë arritur 1230 euro, të cilat i kam tërhequr nga numri im i xhirollogarisë në TEB- Bank pas një kohe me ka thirr dikush nga ministria dhe me ka treguar që do të vije te unë për super kontrolle, nga arsyeja se unë paskam pranuar subvencione për vreshta ekzistuese, kur jam takuar me ta i kam tregue se unë nuk kultivoj vresht, i kam dërguar të toka të cilën e kam marrë me qira aty edhe është parë që ajo tokë nuk ka hardhi. Unë menjëherë i kam kthyer subvencionet në vlerë prej 1230 euro, në ministri nëpërmes të xhirollogarisë të tyre, flet pagesën ia kam dhënë A. S.1 dhe ai i ka dorëzuar në ministri. Unë nuk kam nxjerr certifikate vreshtari e as që kam aplikuar personalisht vetë dikund në subvencione, e as që kam vendosur nënshkrimin në ndonjë dokument. Nuk kam nënshkruar ndonjë kontrate për qiranë, thjesht i kam besuar

A.1 nga se 16 vjet punoj me te, bile 500 euro që është dashur me ja dhënë unë Italianit e ka kryer Afrimi, pra ka qenë një mirëbesim i ndërsjellët. Me vije keq që ka ndodhur ky rast unë nuk kam ditur që dokumentet e mia po përdoren për subvencione, por kam menduar se kam marrë tokë me qira, për kultivimin e mjedrave ose hardhisë. Nuk kemi mundur me kultivuar axhë ne atë tokë, nga se fshataret e fshatrave për rreth nuk kanë lejuar që të punohet në ato toka.

I akuzuari Xh. S. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se është e vërtetë që i kam marrë në vitin 2014 dhe 2015 disa të holla në emër të subvencioneve, ne vitin 2014 kam marrë 2290 euro, dhe në vitin 2015 kam marrë ne emër të subvencioneve 1430 euro, është fakte se unë nuk e kam ditur që këto para janë marrë për subvencione për vreshta ekzistuese, nga se Italiani kur ka ardhur dhe kur jemi takuar me tre në lokalin e A. S.1, ai na ka shpjeguar që do të marrim tokë me qira dhe unë kam pas me mbjellë mjedra në atë tokë dhe kam menduar se ato para mi kanë qitë në xhirollogari për këtë qëllim kështu është e vërtetë nga shuma totale e parave që unë i kam marrë, vetëm 600 euro i kam mbajtur për vete, ndërsa mbetjen e parave të tërhequra nga xhirollogaria ime i kam qar ne lokalin e A. S.1 për t'ia dhënë Italianit, nga se marrëveshja me Italianin ka qenë e tillë, Italianin nuk e njoh ai erdh në lokalin e A.1 dhe kemi qenë disa persona që kemi vendos të hymë në marrëveshje me të. Nuk kam lidhur kurrfarë marrëveshje me shkrim me te për marrjen e tokës me qira, nga se i kam besuar A.1 dhe se në atë kohë kam qenë punëtori i tij.

I akuzuari L. T. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se me ka thirr miku im A. S.1 tek të cili kam punuar me herët, me ka njoftuar se një Italian pe lëshon një tokë me qira, unë kam qenë i interesuar që në këtë tokë të zhvilloj veprimtarinë e vreshtarisë. Po ashtu kur unë i kam dhënë këtij Italianit certifikatën e pagimit të tatimit në pronë, kartelën e bankës dhe fotokopjen e letërnjoftimit dhe 500 euro, mua me ka treguar Italiani që 500 euro i duhen atij për ti paguar shpenzimet atij rreth rregullimit të dokumentacionit dhe unë e kam ditur që këtë tokë që e kam marrë me qira do të më lëshohen parat ne formë të subvencioneve për zhvillimin e vreshtarisë. Parat i kem i pranuar me vonesë dhe nuk kemi mundur ta punojmë tokën. Po ashtu edhe banorët e fshatrave për rreth nuk i kanë lënë Italianit qasje në atë tokë dhe nga ajo kohë nuk e kam parë Italianin. Nuk e di se kush ka aplikuar në emrin tim për subvencione, personalisht nuk kam aplikuar.

I akuzuari F. H. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se kam qenë i interesuar të merrem me vreshtari, kështu ia kam dhënë dokumentet Italianit si vërtetimin e pagimit të tatimit në pronë, kopjen e kartelës së bankës dhe kopjen e letërnjoftimit si dhe 500 euro. Italiani me ka thënë që duhet ti jap 500 euro, në emër të rregullimit të dokumentacionit për të filluar biznes. Nuk kam lidhur kurrfarë kontrate me shkrim. Këtë tokë nuk e kam punuar asnjëherë nga se menjëherë me ka ardhur ftesa nga ministria dhe kam kuptuar se dikush me ka mashtruar, të hollat të cilat i kam pranuar i kam kthyer në ministri.

Gjykata duke analizuar secilën nga mbrojtjet e të akuzuarve të cilët janë shpallur fajtorë është vërtetuar fakti se të akuzuarit kanë qenë në dijeni se do të përfitojnë subvencione pa pasur vreshta dhe se kanë siguruar edhe dokumentacionin përkatës për përfitimin e subvencioneve duke përdorur edhe certifikata të vreshtarit të falsifikuara. ndërsa pjesën tjetër të mbrojtjes gjykata e hudh si të pa bazuar, ngase është në

kundërshtim me provat e administruara dhe se kjo mbrojtje është drejtuar kah shmangia e përgjegjësisë penale dhe si të tillë gjykata nuk ia falë besimin.

I akuzuari L. S. në mbrojtjen e tij si në prokurori ashtu edhe në shqyrtimin kryesor ndër të tjera ka theksuar se në vitin 2014 urdhri i krye shefit z. E. H. ka qenë që të vizitohen vetëm 2% e vreshtarëve. Përzgjedhja është bërë nga stafi në mënyre të rastësishme pra pa përcaktuar se te kush do të shkohet. Ndërsa për vitin 2015 janë përzgjedhë 50% e aplikuarve vreshtarë tu bëhet kontrolli. Gjatë këtij kontrolli nuk është zbuluar që dikush nga të aplikuarit po i keqpërdor subvencionet, pra të gjithë që kemi shkuar nuk kanë qenë persona që janë të përmendur me aktvendim. Pasi që në Web faqe zyrtare të AZHB-së, janë shpallur emrat e fituesve të subvencioneve, nga enti i verarisë dhe vreshtarisë na kanë njoftuar që disa nga përfituesit e subvencioneve për vreshta ekzistuese nuk janë vreshtar, kështu ne e kemi organizuar një super kontroll, me ç 'rast dhe kemi zbuluar që personat të cilët janë të përmendur në këtë aktakuzë, nuk janë vreshtar, nga ata kemi kërkuar që ti kthejnë mjetet sipas procedurës së paraparë. Aplikacionet i ka përpiluar stafi im, nuk ka qenë puna e ndarë sipas regjioneve ose komunave por që të gjithë kanë punuar bashkërisht, unë nuk kam qenë i njoftuar që certifikatat e vreshtarit e kanë një numër serik. Asnjërin prej këtyre personave nuk i njoh. Në atë kohë nuk ka prodhuar ndonjë dokument softveri për të kuptuar se kush e ka aprovuar aplikacionin, në vitin 2014 është punuar në excel, e me vonë në vitin 2015 e kemi pasur një program i cili nuk ka gjeneruar dokument ku do të nënshkruaj zyrtari që ka miratuar, në atë program ka pasur qasje stafi im dhe se çdo njeri ka pas shifrën e përdoruesit, por nuk e di se në vitin 2014 dhe 2015 kush i ka pranuar aplikacionet. Unë jam shefi i divizionit për pagesa direktë, përgatis thirrjet për aplikim për pagesa direkte, përgatis trajnime për nevojat e zyrtareve, përgatis raportet e shpenzimeve, njoftoj krye shefin për punët e bëra në divizion dhe e mbi këqyri stafin në punë. Nuk kam mundësi që ti mbikëqyri 45.000 mijë aplikacione: Procesi i aplikimit fillon as publikimit të thirrjes për aplikim, aplikimi behët ne zyrat komunale për bujqësi pas mbylljes së aplikimit, aplikacionet sillen në AZHB, pastaj fillon shqyrtimi administrativ i aplikacioneve, shqyrtimi administrativ i aplikacioneve nën kupton kontrollimin e aplikacionit se a është ne përputhje me kriteret dhe dokumentet e kërkuara sipas thirrjes për aplikim. Shqyrtimin administrativ të aplikacionit e bën stafi teknik i punuar ne divizionin për pagesa direktë, duke shtuar se në divizionin për pagesa direkte ka qenë vetëm një zyrtar me kontratë të rregullt, ndërsa për shqyrtimin e aplikacioneve për vreshta kanë qenë të punuar 5 student dhe 4 praktikant, stafi ka qenë pa përvojë dhe i pa kualifikuar . Pranimin e stafit në punë e bënë administrata dhe krye shefi ekzekutiv. Unë personalisht nuk merrem me shqyrtimin e aplikacioneve, unë vetëm e mbikëqyri stafin rreth shqyrtimit të aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve vendimin për miratim ose refuzim të aplikacionit, e bënë zyrtari që e ka kontrolluar atë aplikacion. Te aplikacionet që miratohen për pagesë krijohet një listë të vreshtat ka qenë rreth 3000 fermerë, ajo listë sillet tek unë dhe krye shefi ekzekutiv dhe miratohet për pagesë, gjegjësisht autorizohet për pagesë, unë krye shefi e nënshkruaj këtë listë për pagesë. Unë nuk kam pasur asnjë njoftim për ndonjë keqpërdorim të mundshëm, njoftimin vetëm e kam marrur nga departamenti për verari dhe vreshtari, pas këtij njoftimi kemi organizuar super kontrole dhe kemi marrë të gjitha masat e nevojshme pas kthimit të raportit të inspektoreve nga terreni. Nga ky inspektim raportet janë kthyer negative për këta fermer që iu është bërë super kontrole dhe ne bazë të artë raporteve ne kemi kërkuar edhe kthimin e mjeteve. Kjo kontroll është bërë pas pagesës, në momentin kur është bërë njoftimi nga departamenti i verërave dhe vreshtave. AZHB ruan të drejtën që të bëjë super kontroll edhe pas pagesës tek fermerët, te grandet është periudha 5 vjeçare pas pagesës që mund të bëjmë kontrole, ndërsa të

subvencionet në momentin e marrjes së informatës shtesë. Neni 13 i rregullores 01/12 bën përshkrimin e detyrave të drejtorisë së pagesave direktet, kjo drejtori nuk ka qenë e themeluar në atë kohë, është themeluar tash para një muaji, nuk kanë qenë të themeluar asnjëri prej sektorëve që kërkohet në kuadër të drejtorisë së pagesave direktet, si që e ka paraparë rregullorja me nr. 01/12 realisht ka qenë një rregullore e nënshkruar nga ministri, mirëpo nuk është funksionalizuar asnjëherë, themelimi i drejtorive sipas kësaj rregullore ka filluar tash para një muaji gjithashtu stafi i planifikuar sipas asaj rregullore nuk është rekrutuar asnjëherë. Sipas udhëzimit administrativ me nr. 02/2014 për pagesa direktet në bujqësi përgjegjës për kontrollin në teren është divizioni i kontrollit. Përzgjedhja e kontrollës në teren për verifikimin e aplikuesve për subvencione dhe selektimi i fermerëve për kontrole në teren bëhet duke udhëzuar në udhëzimin administrativ për pagesa direktet në vitin 2015 janë kontrolluar mbi 50% të fermerëve. Selektimi bëhet në bazë të madhësisë së sipërfaqes ose numrit të krerëve të kafshëve, në rastin konkrete kemi kontrolluar fermerët të cilët kanë pasur sipërfaqe me të madhe e ata janë kontrolluar 100%. Te vreshtat nëse nuk gaboj ka qenë mbi një hektar të kontrollohen në teren por përgjegjës është divizioni i kontrollit në teren.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit L. S., gjykata këtë mbrojtje e ka vlerësuar se është në pajtim me të gjitha provat materiale dhe se nga kjo mbrojtje nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet ky i akuzuar. Nga kjo mbrojtje është vërtetuar fakti se i akuzuari L. S. është shef i divizionit për pagesa direkte dhe se gjatë kampanjës janë stafi teknik që e bënë kontrollimin e aplikacioneve, ky staf teknik përbëhet nga praktikant dhe student të cilët angazhohen nga AZHB-ja, pasi që ky divizion pa fajin e shefit ka mungesë të resurseve njerëzore dhe kjo është politika e AZHB-së. Këto aplikacione kontrollohen nga stafi teknik siqë janë student dhe praktikant dhe nga ta formohet lista për ata fermerë që dokumentacionin e kanë në rregull dhe se kjo listë dërgohet tek shefi (i akuzuari L. S.) për të marr aprovimin dhe në fund të kësaj aprovimi përfundimtar e bënë krye shefi i AZHB-së. Këto fakte janë vërtetuar nga secila provë që është administruara e sidomos nga dëshmitë e dëshmitarëve e posaçërisht nga dëshmitarja F. I. e cila drejtpërdrejt ka marrë pjesë në kontrollimin administrativ të dokumentacionit dhe nga dëshmitari E. H. i cili ka theksuar se AZHB pranon student dhe praktikant për kontrollim të dokumentacionit si dhe pas kontrollimit të dokumentacionit përpilohet lista dhe ajo listë shkon tek shefi i pagesave direkte për miratim dhe pas miratimit nga ai atëherë vjen tek krye shefi respektivisht tek E. H. krye shefi i AZHB-së dhe nga ky bëhet aprovimi përfundimtar. Pra kjo mbrojtje është në pajtim me të gjitha provat me administruara dhe se me këtë mbrojtje nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari L. S.

Bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor e të cilat janë elaboruar secila veç e veç dhe vlerësuar me ndërgjegje në pajtim me nenin 361 paragraf 2 të KPP-së.

Gjykata këto fakte për të akuzuarit A. S.1, I. S., A. S.2, E. S., V. K., A. P., L. P., Xh. S., Xh. S., L. T. dhe F. H., i ka vërtetuar me provat e administruara. Nga dëshmitë e dëshmitarëve që janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor të cilët kanë theksuar si në vitin 2014 dhe 2015 janë vërtetuar se 13 fermerë kanë keqpërdorë subvencionet. Të akuzuarit të cilët janë shpallur fajtorë pranë DVV kanë aplikuar kinse janë vreshtar, aplikacionit ia kanë bashkangjitur certifikatat e falsifikuara të vreshtarit apo duke i përdorur certifikatat e personave të tjerë, të gjitha këto veprime i kanë ndërmarr me qëllim të përftimit të subvencioneve. Nuk është kontestuese fakti se të akuzuarit kanë përdorur këto certifikata ngase secila prej tyre është

elaboruar veç e veç si dhe shumë prova tjera materiale të cilat padyshim që kanë vërtetuar fakte të rëndësishme në marrjen e këtij aktgjykimit dhe duke vërtetuar saktë veprimet e të akuzuarve dhe dashjen e tyre direkte, asnjëri nga ta asnjëherë nuk është marr me vreshtari apo kultivimin e hardhisë apo të rrushit. Por qëllimi i tyre ka qenë me ardh deri të përfitimi i mjeteve të subvencioneve në mënyrë të kundërligjshme duke e shfrytëzuar numrin e madh të aplikuesve dhe mungesën e kontrolleve, të gjithë kanë pas lidhje njëri me tjetrin, personin ashtu siq e theksojnë të akuzuarit se ka qenë Italian dhe përkthyesin e tij e supozojnë ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar se ky person ka biseduar me të akuzuarit dhe se kinse i ka mashtruar, përveç që të akuzuarit e përmendin këtë person askund tjetër ose me asnjë provë nuk përmendet se të akuzuarit kanë qenë të mashtruar nga një person Italian. Edhe po të kishin biseduar me këtë person të akuzuarit kanë qenë në dijeni se po përfitojnë të mira materiale pa bazë ngase asnjëri nga ta asnjëherë nuk është marr me bujqësi apo blegtori, të gjithë kanë punuar në punë apo zanate të tjera. Të akuzuarit gjatë super kontrolles janë ftuar nga AZHB dhe secili nga ta ka pranuar se ka përfituar shuma të ndryshme dhe se shumica nga ta edhe i ka kthyer mjetet e marrura për vitin 2014, ndërsa për vitin 2015 nuk janë kthyer mjetet e përfituara me anë subvencioneve e këto fakte janë vërtetuar me provat materiale. Gjykata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke e analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku, të cilave iu ka falur besimin e të cilat i ka marr si vendimtare në marrjen e këtij aktgjykimi, në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprave penale të cilat iu vihen në barrë, në atë mënyrë që të akuzuarit me vetëdije të plotë dhe të vetëdijshëm për veprimet e veta kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen, andaj gjykata të njëjtit i ka shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar dënimet me gjobë, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

Gjykata këto fakte për të akuzuarin L. S., i ka vërtetuar me provat e administruara. Me asnjë nga dëshmitë e dëshmitarëve apo provave materiale nuk është vërtetuar teza e akuzës. Asnjë nga dëshmitarët të cilët janë dëgjuar nuk ka cekur se i akuzuari L. S. ka qenë në dijeni se po keqpërdoren subvencionet. Dëshmitarët e dëgjuar secili nga ta ka pas detyrat e tija dhe njeherit para gjykatës i kanë theksuar ato detyra dhe në asnjë moment apo dëshmie nuk është vërtetuar ndonjë element i veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari. Asnjëri prej tyre nuk ka theksuar se i akuzuari ka qenë në dijeni se po keqpërdoren subvencionet, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për dikend tjetër. Të gjithë kanë theksuar se janë njoftuar për këto keqpërdorime sikurse i akuzuari. Bazuar edhe në faktin se përfaqësuesja e palës së dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasurore ndaj të akuzuarit L. duke theksuar se në rastin e tij AZHB nuk është e dëmtuar, e deri sa nuk kemi të dëmtuar nuk kemi as elemente të veprës penale, kur dihet se për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të ekzistojë dashja direkte. Po ashtu edhe nga provat materiale në asnjë rast nuk është vërtetuar se i akuzuari ka qenë në dijeni se po keqpërdoren subvencionet apo ndonjë veprim i tij lidhur me keqpërdorim. I akuzuari sikurse krye shefi i AZHB-së janë njoftuar nga zyra rajonale se 13 fermerë që gjenden në listat për pagesa direkte nuk janë fermerë, me të marr këtë informatë i akuzuari së bashku me kryeshin angazhojnë ekipet lidhur me super kontrollet tek këta persona dhe gjatë super kontrolles edhe vërtetohet fakti se këta janë përfitues të subvencioneve në mënyrë të paligjshme dhe se nga ta kanë kërkuar edhe kthimin e mjeteve të përfituara në mënyrë të pa ligjshme. Gjykata konstatoi dhe vërtetoi gjatë shqyrtimit gjyqësor se asnjë veprim që ka ndërmarr i akuzuari nuk përkon me gjendjen faktike për të cilën pretendon organi i akuzës. Së fundmi nga provat e administruara, gjykata vetëm sa e forcoi bindjen e saj se në veprimet e të akuzuarit L. S., nuk formohen elementet dhe tiparet e veprës penale

keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 nënparag. 2.1 të KP-së. Duke pasur parasysh se për ekzistimin e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autorizimit zyrtar, për të cilën akuzohet i akuzuari duhet të ekzistojë qëllimi për të përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete ose për tjetrin, apo për ti shkaktuar dëm tjetrit dhe gjykata gjatë administrimit të të gjitha provave, dëgjimit të dëshmitarëve nuk ka mund të vërtetojë qëllimin e të akuzuarit për kryerjen e kësaj veprë penale, që i njëjti duke shfrytëzuar autorizimet e tij, i ka tejkalluar kompetencat ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare për të përfituar dobi pasurore të kundërligjshme. Së këndejmi, pas vlerësimit të provave materiale (provave të lart theksuara), dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në tërësi, dhe të gjitha së bashku, gjykata gjeti se nuk është vërtetuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë për të cilën akuzohet nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KP-së. Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, përcakton: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkallon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër...”. Pra, përgjegjësinë penale për këtë veprë penale një i akuzuar e ka nëse si person zyrtar e shfrytëzon detyrën apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër duke i shkaktuar dëm personit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, e që në rastin konkret nuk është provuar një gjë e tillë. Ndërsa neni 22 i KP-së, përcakton se “dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethana faktike”, pra qëllimin e kryerjes së veprës penale nxirret nga provat dhe faktet e shtjelluara në një çështje penale. Andaj duke u bazuar nga të lartcekurat dhe provat të cilat u administruan nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, prandaj të njëjtin e liroi nga akuza.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve të cilët i shpalli fajtorë vlerësoj të gjitha rrethanat si ato rënduese dhe ato lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin A. S.1 ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin I. S. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin A. S.2 ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin E. S. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin V. K. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin A. P. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin L. P. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin Xh. S. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin Xh. S. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin L. T. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Si rrethanë renduese për të akuzuarin F. H. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, ka qenë i vetëdijshtëm për veprimet që i ka ndërmarr. Si rrethanë lehtësuese është marrë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë, gjendjen ekonomike të tij, sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, është mbajtës i familjes, është familjar.

Prandaj, gjykata të akuzuarve të cilët i shpalli fajtor iu shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla, si dhe këto dënime do të jenë preventivë edhe për personat tjerë që të përmbahen nga veprimet e tilla për çka është edhe efekti i dënimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil juridiko civil, gjykata e bazoi në kuptim të nenit nenit 463 par.1 e 2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.53/2017 më datë 14.03.2018**

**Procesmbajtësja
Florije Kolukaj**

**Kryetari i trupit gjykues,
Artan Sejrani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.